

RELACION TEKNIK

MBI OBJEKTIN

**“RIKONSTRUKSION ZYRA POSTARE FILIALI ELBASAN DHE FILIALI KORÇË
DREJTORIA PËRGJITHSHME POSTA SHQIPTARE SH.A**

POROSITES : Filiali FILIALI ELBASAN DHE KORÇË

PROJEKTUES

SHOQERIA “Rean 95” SHPK

Drejtues teknik

Ing.Razije NAIPI

Licence 1865/14 date 17.07.2018

RELACION TEKNIK

MBI

**Objekti: “Rikonstruksion Zyra Postare Filiali Elbasan dhe Filiali Korçe”
Drejtoria Përgjithshme Posta Shqiptare Sh.A**

Bazuar ne detyren e projektimit te hartuar nga Drejtoria e Pergjithshme Posta Shqiptare Sh.A mbi gjendjen ekzistuese te objekteve Shoqeria projektuese **“Rean 95”** shpk **ju relaton** si me poshte vijon:

Në kuadrin e përmirësimit të kushteve dhe ambienteve duke synuar rritjen e cilesisë të të gjitha llojeve të shërbimit për klientët dhe gjithashtu përmirësimin e kushteve të punës për punjonjësit e saj, kërkon me ane të rikonstruksionit dhe rikonceptimit të ambienteve të krijoj rivitalizimin e këtyre zyrave. Domosdoshmëria e përafritimit me standardet Evropiane si dhe implementimi i përvojave dhe modeleve të suksesshme janë rrugët themelore ku po ecën Drejtoria Përgjithshme e Postes Shqiptare Sh.A.

Per kete arsye Drejtoria Përgjithshme e Postes Shqiptare Sh.A. ka hartuar këtë **Detyrë Projektimi** që ka për qëllim **“Hartimi i projekteve të rikonstruksioneve Elbasan dhe Korçe”**.

Investimet për këtë objekt do të përfshijë gjithesej 17 Zyra postare me shtrirje gjeografike ne Lindje dhe ne Shqiperine e mesme dhe si:

- 1. Zyra Postare Pirg (Filiali Korce)**
- 2. Zyra Postare Mollas (Filiali Korce)**
- 3. Zyra Postare Dardh (Filiali Korce)**
- 4. Zyra Postare Drenove (Filiali Korce)**
- 5. Zyra Postare Voskopoje (Filiali Korce)**
- 6. Zyra Qendër + Zyrat e Administratës (Filiali Elbasan)**
- 7. Zyra Postare Nr.5 (Filiali Elbasan)**
- 8. Zyra Postare Librazhd - Qendër (Filiali Elbasan)**
- 9. Zyra Postare Hotolisht (Filiali Elbasan)**
- 10. Zyra Postare Qukës (Filiali Elbasan)**
- 11. Zyra Postare Peqin (Filiali Elbasan)**
- 12. Zyra Postare Gramsh (Filiali Elbasan)**
- 13. Zyra Postare Cerrik (Filiali Elbasan)**
- 14. Zyra Postare Llixhe (Filiali Elbasan)**
- 15. Zyra Postare Belësh (Filiali Elbasan)**
- 16. Zyra Shtërmën (Filiali Elbasan)**
- 17. Zyra Postare Gjinar (Filiali Elbasan)**

ZHVILLIMI I PROJEKTIT

1. Zyra Postare Pirg (Filiali Korce) - është pjesë e Filialit Berat me vendodhje në aksin e rrugës kryesore Elbasan-Korcë në Fshatin Pirg.Zyra ka një sipërfaqe prej 88 m2.Objekti është një ndërtesë një katëshe njëkatëshe me çati të rënë plotësisht, nuk ka dyer e dritare , nuk ka pllaka ,nuk ka instalime elektrike dhe hidraulike , muret anësore dhe ato të brendshme në pjesën më të madhe janë shkatëruar, pjesa e murit prej guri tek biblioteka është rrënuar, suvatimi i brendshëm dhe i jashtëm ka rënë.

Ka lindur nevojshmeria e rindertimit te kesaj Zyre Postare pasi Ekzistuesja eshte shembur ne pjesen me te madhe te saj . Do te projektohet ndertesat ne sistemin Tra –Kollone, me çati te re me tjegulla marsejeze me pjeresi 25 % vetem ne nje drejtim.

2. Zyra Postare Mollas (Filiali Korçe)- ndodhet në dalje të qytetit të Korçës në anë të rrugës nacionale Korçë-Ersekë. Siperipërfaqje e kesaj zyre eshte 52 m2.Objekti është një ndërtesë një katëshe e ndërtuar përpara viteve 1990. Ambjenti përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe tre hapësira që shërbejnë si magazinë dhe ambjente ndihmëse. Godina është me çati prej tjegullash. Çatia është pjesërisht e dëmtuar dhe si rezultat i dëmtimit të saj të gjitha muret anësore të brendshme dhe tavani janë dëmtuar nga lagështia dhe janë veshur me myk. Shkallët e jashtme në hyrja të objektit janë të dëmtuara. Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër,e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

Suvatimet brenda janë të dëmtuara ndërsa suvatimi i jashtëm është totalisht i dëmtuar dhe i rënuar. Tualeti është në gjendje të rënduar dhe nuk funksionon fare pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar.

3. Zyra Postare Dardh (Filiali Korçe) - ndodhet në qendër të fshatit turistik të Dardhës në rrethin e Korçës. Objekti ndodhet në katin përdhe të një ndërtesë dykatëshe .Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 35 m2. Zyra postare përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe një hapësire që shërben si magazinë dhe ambjent ndihmëse. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara ,tualeti është në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Rrjeti elektrik i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhojë e mos investimit shumë vjecar. Brenda të gjitha suvatimet,dyert,dritaret jane totalisht amortizuar , muret anësore kane prani të lagështirës. Banakët e shërbimit,tavolinat dhe karriget janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje, dyert janë të siguruara me qepena të vjetër që kane dale jashte funksioni dhe të dëmtuar. Punimet brenda kane nevojë për një rikonstrukcion total.Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër,e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

4. Zyra Postare Drenove (Filiali Korçe) - ndodhet në qendër të fshatit Drenovë- Korçë . Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 35 m2 e cila përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe një hapësire që shërben si magazinë dhe ambjent ndihmëse. Objekti është një ndërtesë një katëshe me çati pjesërisht te dëmtuar duke sjelle lageshti ne muret anësore të brendshme, tavan dhe janë veshur me myk. Suvatimi i jashtëm dhe i brendshem është totalisht i dëmtuar. Tualeti është në gjendje të rënduar dhe i dale jashte funksioni pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar.Shkallët e jashtme në hyrja të objektit janë të dëmtuara. Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër, dhe ka logon e vjetër të postës.

5. Zyra Postare Voskopoje (Filiali Korçe) - ndodhet në qendër të fshatit Voskopojë-Korçë. Zyra Postare përbëhet nga një sallë shërbimi,tualet dhe dy hapësira që shërbejnë si magazinë dhe ambjente ndihmëse me një sipërfaqe prej 47 m2.Kjo zyrë është një godinë njëkatëshe pjesërisht e amortizuar.Suvatimet e brendshme dhe të jashtëm janë pjesërisht të dëmtuara nga lagështi.Dyert dhe dritaret janë pjesërisht të amortizuara.Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër,e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

6. Zyra Qendër + Zyrat e Administratës (Filiali Elbasan) - ndodhet në Qendër të Qytetit në lagje “28 Nëntori”, Rr. “Lublin Dilja”.Ambjentet e kesaj zyre postare ndodhen katin përdhe të një pallati 5 katësh tëndërtuar para viteve 1990.Kjo zyrë postare është zyra më e madhe postare qe ka filiali i Elbasanit si për nga madhesia,volumi i shërbimeve dhe numri i punjonjësve.Ambjenti ka një sipërfaqe prej 390 m2 dhe përbehet nga salla e madhe e shërbimit e cilazë sipërfaqen më të madhe si edhe zyrat e administratës.

Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhojë e mos investimit shumë vjeçar. Ndiçimi i dobët dhe i dëmtuar, tavanet e varura të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje. Tualetët janë në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje.

7. Zyra Postare Nr.5 (Filiali Elbasan) - ndodhet në lagjen Skënderaj rrugën kryesore Bexhet Ollidashi Pll.26, afër stadiumit të qytetit. Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 54.7 m² pozicionuar në katin përdhe të një pallati 5 katësh të ndërtuar para viteve 1990. Ambjenti përbehet nga salla e madhe e shërbimit cila zë sipërfaqen me të madhe të kësaj dhe dy ambjente ndihmëse që shërbejnë si magazinë dhe ambjente ndihmëse. Nga brenda janë totalisht të amortizuara suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik i amortizuar dhe i vjetër. Ndiçimi i dobët dhe tavanet e varura të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje pasi nuk është bërë asnjë rikonstruksion për një kohë të gjatë. Tualeti është në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë demtuar, gervishtur dhe të dala boje. Dritaret dhe dyert janë të siguruara me qepena të vjetër që mezi hapen e mbyllen dhe të dëmtuar. Punimet brenda kanë nevojë për një rikonstruksion total. Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër, e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

8. Zyra Postare Librazhd - Qendër (Filiali Elbasan) - ndodhet në lagjen Nr1 rrugën “Gjergj Golemi” Nr.37 të Qytetit të Librazhdit pranë pedonale së re pozicionuar në katin përdhe të një pallati 5 katësh të vjetër. Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 66 m². Ambjenti përbehet nga salla e madhe e shërbimit që zë sipërfaqen me të madhe të kësaj dhe tre ambjente ndihmëse që shërbejnë si zyra, magazinë dhe ambjente ndihmëse. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje pasi nuk është bërë asnjë rikonstruksion për një kohë të gjatë. Tualeti është në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë demtuar, gervishtur dhe të dala boje. Punimet brenda kanë nevojë për një rikonstruksion total. Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër, e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

9. Zyra Postare Hotolisht (Filiali Elbasan) - ndodhet në qendër të fshatit Hotolisht, njesia Administrative Hotolisht në aksin e rrugës nacionale kryesore Elbasan-Korcë. Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 97.2 m². Objekti është një ndërtesë një katëshe e ndërtuar përpara viteve 1990. Kjo Zyra Postare një kateshe përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe dy ambjente që shërbejnë si magazinë dhe një tjetër ambjent ndihmës.

Tarraca ka probleme të theksuara përse i përket hidroizolimit pasi si rezultat i dëmtimit të saj të gjitha muret anësore të brendshme dhe tavani janë dëmtuar nga lagështia dhe janë veshur me myk. Suvatimi I brendshëm dhe I jashtëm është totalisht i dëmtuar. Dyert, dritaret, rrjeti elektrik Tualeti është në gjendje të rënduar dhe nuk funksionon fare pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar. Shkallët e jashtme në hyrja të ndërtesës janë të thyera dhe të dala boje. Dyert dhe dritaret janë tejet të amortizuara. Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër dhe ka logon e vjetër të postës

10. Zyra Postare Qukës (Filiali Elbasan) - ndodhet në qendër të fshatit Qukës të Filialit Elbasan në njësinë Administrative Prenjas. me një sipërfaqe prej 29 m². Kjo zyrë postare përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe një ambjent që shërben si magazinë dhe ambjent ndihmës. Tarraca ka probleme të theksuara përse i përket hidroizolimit pasi si rezultat i dëmtimit të saj të gjitha muret anësore të brendshme dhe tavani janë dëmtuar nga lagështia dhe janë veshur me myk. Tualeti është në gjendje të rënduar dhe nuk funksionon fare pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar. Shkallët e jashtme në hyrja të ndërtesës janë të thyera dhe të dala boje. Dyert dhe dritaret

janëtejet të amortizuara. Tabela treguese e Zyrës Postarë shume e vjetër, e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës. Suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i dëmtuar. Suvatimi i jashtëm është totalisht i dëmtuar dhe i rënuar.

11. Zyra Postare Peqin (Filiali Elbasan)- ndodhet në në katin përdhe të një pallati të ndërtuar para viteve 1990 në lagjen “Teqe”-Peqin me një sipërfaqe prej 185 m². Zyra Postare përbëhet nga dy salla shërbimi, një tualet dy hapësira nga prapa që shërbejnë si magazina. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik i amortizuar dhe i vjetër. Ndriçimi i dobët dhe i dëmtuar, tavanet e varura të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara. Në muret anësore ka prani të lagështirës. Tualeti është në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara. Tabela e emërimit të zyrës është e thyer., Kangjella e jashtme janë të palyera.

12. Zyra Postare Gramsh (Filiali Elbasan) - ndodhet në katin përdhe të një pallati të vjetër në lagjen. Lagj. Holta Gramsh. Me një sipërfaqe prej 11.28 m², zyra postare përbëhet nga vetëm një sallë. Të gjitha suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhojë e mos investimit shumë vjeçar. Ndriçimi i dobët dhe i dëmtuar, tavanet e varura të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje pasi nuk është bërë asnjë rikonstruksion për një kohë të gjatë. Në muret anësore ka prani të lagështirës.. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje. Nuk ka tualet

13. Zyra Postare Cerrik (Filiali Elbasan) - ndodhet lagjen Nr.2, në “Gjimnazisti”. Kjo Zyrë Postare përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe tre hapësira që shërbejnë si magazinë dhe ambiente ndihmëse. Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 21.88 m².

Tarraca ka probleme të theksuara përse i përket hidroizolimit pasi si rezultat i dëmtimit të saj të gjitha muret anësore të brendshme. Suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar. Suvatimi i jashtëm është i rënuar. Tualeti është në gjendje të rënduar dhe nuk funksionon fare pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar. Shkallët e jashtme në hyrja të ndërtesës janë të thyera dhe të dala boje. Dyert dhe dritaret janëtejet të amortizuara. Tabela treguese e zyrës postarë shume e vjetër, e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

14. Zyra Postare Llixhe (Filiali Elbasan)- ndodhet në fshati Llixhë të Elbasanit pranë fshatit Tregan, në njësinë administrative Tregan zonë kjo mjaft e njohur për ujërat tërmale shëruese. Zyra Postare ndodhet në një lartësi nga rruga kryesore e pozicionuar në qendër të llixhave dhe ka një arkitekture të rregullt. Në përbërje të saj ka një sallë shërbimi, tualet dhe 4 hapësira që shërbejnë si magazinë, depo dhe ambiente ndihmëse. Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 144.5 m².

Tarraca ka probleme të theksuara përse i përket hidroizolimit pasi si rezultat i dëmtimit të saj të gjitha muret anësore të brendshme dhe tavani janë dëmtuar nga lagështia dhe janë veshur me myk. Brenda suvatimet, dyert, dritaret janë dëmtuar dhe rënuar për shkak të pranisë së squfurit nga ujërat tërmale. Tualeti është në gjendje të rënduar dhe nuk funksionon fare pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar. Shkallët e jashtme në hyrja të ndërtesës janë të thyera. Meqenëse kjo Zyrë Postare ndodhet në një lartësi nga rruga kryesore ajo nuk ka shkallë për tu ngjitur në hyrjen e saj. Dyert dhe dritaret janëtejet të amortizuara. Tabela treguese e Zyrës Postarë është e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

15. Zyra Postare Belësh (Filiali Elbasan) - ndodhet në rrugën kryesorenë hyrjen e Belshit pranë pedonales së re. Ambjentet e kësaj zyre postare ndodhen katin përdhe të një pallati 4 katësh të ndërtuar para viteve 1990. Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 62.6 m². Salla e madhe e shërbimit që zë sipërfaqen me të madhe të kësaj dhe tre ambjente ndihmëse që shërbejnë si zyra, magazinë dhe ambjente ndihmëse. Tualeti është në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të siguruara me qepena të vjetër te dala jashte funksioni.

Tabela treguese e zyrës postare shume e vjetër, e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

16. Zyra Shtërmen (Filiali Elbasan) - ndodhet në qendër të fshatit me të njëjtin emër. Kjo Zyrë Postare përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe tre hapësira që shërbejnë si magazinë dhe ambjente ndihmëse. Kjo zyrë ka një sipërfaqe prej 76.7 m². Tarraca ka probleme të theksuara përsa i përket hidroizolimit pasi si rezultat i dëmtimit të saj të gjitha muret anësore të brendshme dhe tavani janë dëmtuar nga lagështia dhe janë veshur me myk. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar. Suvatimi i jashtëm është totalisht i dëmtuar dhe i rënuar. Tualeti është në gjendje të rënduar dhe nuk funksionon fare pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar. Shkallët e jashtme në hyrja të ndërtesës janë të thyera dhe të dala boje. Dyert dhe dritaret janë tejet të amortizuara.

17. Zyra Postare Gjinar (Filiali Elbasan) - ndodhet në qendër të fshatit. Objekti është në katin përdhe të një ndërtesë dykatëshe me një sipërfaqe prej 47.3 m². Kjo Zyrë Postare përbëhet nga një sallë shërbimi, tualet dhe dy hapësira që shërbejnë si magazinë dhe ambjente ndihmëse. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar. Suvatimi i jashtëm është totalisht i dëmtuar dhe i rënuar. Tualeti është në gjendje të rënduar dhe nuk funksionon fare pasi pajisjet dhe tubat e ujit të pijshëm janë tërësisht të dëmtuar. Shkallët e jashtme në hyrja të ndërtesës janë të thyera dhe të dala boje. Dyert dhe dritaret janë tejet të amortizuara. Tabela treguese e Zyrës Postare shume e vjetër, e dëmtuar dhe ka logon e vjetër të postës.

Relatojme se, te gjitha Zyrat postare dhe te shërbimit, kane te njejtat problematika themelore per rikonstrukcionin e tyre.

Taraca

Prishja e shtreses hidroizoluese te taraces. Ndertimi i shtresave hidro e termoizoluese te taraces komplet si dhe sistemi i kullimit te saj .Hidroizolimi i komplet tarracës duke filluar nga prishja e hidroizolimit ekzistues, mbulesës me parapete me pllaka dhe kasetave, tubove të shkarkimit dhe zevendësimin e tyre. Punime ne tarace do te kryhen ne **ZP Llixhe** .

Çatia – do te rindertohet me tjegulla marsejeze me pjeresi 25 % vetem ne nje drejtim ne **ZP. Pirc**

Sistemi i kullimit te taraces jane parashikuar vendosja e ulluqeve vertikale dhe horizontale te reja.

Rifiniturat ku përfshihen te suvatimet e tavaneve ,suvatimet e brendeshme te mureve dhe te jashtme te fasades –eshte parashikuar heqja komplet e suvatimeve te vjetra nga brenda dhe ne fasade dhe realizimi i tyre sipas shtresave e standarteve te kerkuara

- Skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte; Kampionete artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak.

Instalimet elektrike jane parashikuar teresisht te reja sipas standarteve ne fuqi ku perfshihen, prizat, çelsat si dhe kabllot. Instalimet elektrike te reja sherbejne per zyrat e punonjesve ,salla e sherbimit , pritjes, arkiva, tualete etj.

Tualetet –Tualetet do te behen totalisht rikonstruksion sipas zerave ne preventiv dhe specifikimet teknike. Do te vendosen pllaka majolike te reja. Po keshtu edhe sistemi i rrjetit hidrosanitar tubat ujesjelles dhe shkarkimet, pajisjet do te vendosen te reja.

Koridoret – do te kene rikonstruksion te plote qe nga pllakat deri ne suvatime e shtresa si dhe lyerjet.

Pllakat e zyrave dhe koridoreve do te behen te reja sipas specifikimeve teknike ,po keshtu edhe pllakat e jashtme do te rikonstruktohen me pllaka mermeri cilesore te tanishme.

PERSHKRIMI I PUNIMEVE TË BRENDSHME TE NDËRTESËS

Pershtatja e zyrës së **Filialit Qender Elbasan , ZP.Librazhd** duke krijuar ndarje ne ambientet e brendeshme me mur tulle sipas specifikimeve, per shfrytezimin maksimal te tyre.

Dera e hyrjes kryesore do te jete per punonjesit dhe sherbimet. Prishja e suvatimeve të mureve dhe tavaneve percaktuar ne planimetrit bashkelidhur ne projekt.

Heqja komplet e dyerve dhe dritareve. Disa dyer do të bëhen tamburato ose MDF importi me brava sekrete dhe çelësa, ngjyra e tyre do të përcaktohet nga arkitekti, në bashkëpunim me investitorin. Do te vendosen dyer duralumini dhe blindato aty ku eshte e parashikuar. Dritaret do të realizohen me duralumin dopio xham ose duroplastike. Ngjyra e dritareve do të përcaktohet nga arkitekti në bashkëpunim me investitorin.

Dyshemetë do të shtrohen me pllaka gres porcelanato, mat, të cilësisë së parë. Plintusat do të jenë me h=8-10cm.

Ambientet sanitare (WC) do të trajtohen sipas të gjithë kërkesave që kanë këto ambiente për t’u mbrojtur nga lagështira. Ato do të hidroizolohen e të vishen me pllaka majolike deri në lartësinë e parashikuar ne volumet e punimeve. Ambientet e WC-ve do të pajisen me Bolier, WC, lavaman dhe aksesoret përkatës, të furnizuara me ujë të ftohtë e të ngrohtë.

Ambientet e brëndshme do të lyhen me hidromat me përdorim për interierë ndërsa muret nga jashtë ndërtesës do të lyhen me bojë plastike me përdorim për eksterierë. Përdorimi i suvatimit me grafiato sipas pamjes se miratuar nga arkitekti.

Tabela ku shkruhet emri i Zyres se Postave do të përcaktohet nga arkitekti në bashkëpunim me Investitorin

Shkallet do të vishen me mermer dhe me plintusa sipas përcaktimit nga arkitekti në bashkëpunim me investitorin

Ne dritaret e fasades do te vendoset veshje adezive per reklamim.

Ne hyrje te nderteses eshte parashikuar te vihet table e re treguese etalbon ndricim led.

INSTALIMET ELEKTRIKE

Instalimet jane parashikuar të realizohen sipas kushteve dhe kërkesave teknike bashkëkohore, kombinim i prizave bivalente dhe shuko si dhe trefazore ku mund të jetë e nevojshme.

Ndriçimi eshte parashikuar të jetë me fluks sipas projektit dhe normave në fuqi. Do mendohet të bëhet tavani në rrjetin kuadratik me panele gipsi 60*60, vetëm për sallën e shërbimit .Tipi i ndriçuesve do të jetë me llampa luminishentë dhe me panele 60*60 LED te përcaktuara ne specifikimet teknike.

Instalime për sinjalizimin e rrjetit informatik (LAN) dhe telefonik.

INSTALIMET HIDROSANITARE

Ujësjiellësi është parashikuar të realizohet me tuba plastik me 10-16Atm. Për të eliminuar kondensimin, tubat do të vishen me material termoizolues.

Shkarkimet me tuba me spresor 3mm, është parashikuar të maskohen me gips dhe duke lënë pika kontrolli në kate. Kanalizimi i ujrave te zeza do te behet me tub pvc Ø 110 mm.

MOBILIMI

Në keto zyra Postare banaku ekzistues do te rivendoset banak druri me sportele xhami të temperuar, sipas standarteve të postës shqiptare sh.a. Ketu jane parashikuar tavolina pune + komode + rafte dhe rafte mbajtëse.

SISTEMI KONDICIONIMIT DHE VENTILIMIT

Per cdo zyre është parashikuar kondicionere inverter sipas volumit te zyres, si dhe vendosja e sistemit te ventilimit ne zyrat ku është e domosdoshme.

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Investitorin. Stafi që kërkohet duhet të mbulojë :

- Inxhinier ndërtimi
- Inxhinier arkitekt
- Inxhinier elektrik
- Ekspert per vleresime te ndikimit ne mjedis
- Ekspert per studime dhe pergatitjen e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri ne ndertesa.
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Fondi limit i parashikuar për dhe rikonstrukcionet e këtyre objekteve është rreth :

1. Zyra Postare Pirc (Filiali Korçe)	4,500,000 lekë pa TVSH
2. Zyra Postare Mollas (Filiali Korçe)	1,200,000 lekë pa TVSH
3. Zyra Postare Dardh (Filiali Korçe)	1,100,000 lekë pa TVSH
4. Zyra Postare Drenove (Filiali Korçe)	800,000 lekë pa TVSH
5. Zyra Postare Voskopoje (Filiali Korçe)	300,000 lekë pa TVSH
6. Zyra Qendër + Zyrat e Administratës (Filiali Elbasan)	4,500,000 lekë pa TVSH
7. Zyra Postare Nr.5 (Filiali Elbasan)	1,800,000 lekë pa TVSH
8. Zyra Postare Librazhd - Qendër (Filiali Elbasan)	2,500,000 lekë pa TVSH
9. Zyra Postare Hotolisht (Filiali Elbasan)	800,000 lekë pa TVSH
10. Zyra Postare Qukës (Filiali Elbasan)	650,000 lekë pa TVSH
11. Zyra Postare Peqin (Filiali Elbasan)	2,000,000 lekë pa TVSH
12. Zyra Postare Gramsh (Filiali Elbasan)	1,000,000 lekë pa TVSH
13. Zyra Postare Cerrik (Filiali Elbasan)	600,000 lekë pa TVSH
14. Zyra Postare Llixhe (Filiali Elbasan)	3,500,000 lekë pa TVSH
15. Zyra Postare Belësh (Filiali Elbasan)	1,300,000 lekë pa TVSH
16. Zyra Shtërmën (Filiali Elbasan)	800,000 lekë pa TVSH
17. Zyra Postare Gjinar (Filiali Elbasan)	300,000 lekë pa TVSH
Fondi Limit Total	27,650,000 leke pa TVSH

Materiali te paraqitet ne 3 kopje te printuara ne formatin A3 dhe 1(CD).
Preventivi te jete ne tre kopje, si per ate me cmime, ashtu dhe ate pa cmime.
Çmimet duhet te jene cmimet e manualit te miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.629, datë 15.7.2015. “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”

PERSHKRIMI I ZERAVE KRYESORE TE PUNIMEVE

Per rikonstruksionet e zyrave postare jemi bazuar ne detyren e projektimit dhe jane bere verifikimet me foto perkatese per secilin ambjent

Ne rikonstruksionin e godines ekzistuese jane patur parasysht dhe perfshire:

1. Punime rikonstruksioni
2. Pershtatja e godines ne funksion te sherbimit te zyres se postave dhe sherbimit
3. Sistemi elektrik, telefonik dhe LAN

Zerat kryesore te punimeve jane

I	PUNIME PRISHJE E NDERTIMI NE GODINE
II	PUNIME DYER DRITARE
III	PUNIME HIDROSANITARE DHE MNZ
IV	PUNIME ELEKTRIKE
V	PUNIME KONDICIONIMI ,ASPIRIMI
VI	PUNIME TE NDRYSHME

Volumet e punimeve

Sipas matjeve matjeve faktike ne teren jane nxjere volumet e punimeve te detajuara sipas nenobjekteve me siper. Keto volume jane vendosur bashkelidhur projekt preventivit.

PREVENTIVI I ZBATIMIT

Preventivi I punimeve eshte hartuar I detajuar sipas rradhes se punimeve dhe me analizat perkatese per zerat e punimeve qe nuk jane ne mnualet 1-2-3-4 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 629, datë 15.7.2015. “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” , jane bere analizat teknike te cmimeve.

Ne perfundim preventi i Zbatimit perfshire fondin reserve 5% eshte ne total:

VLERA E PUNIMEVE 27,641,729 PA TVSH

VLERA E PUNIMEVE 33,170,075 ME TVSH

Projektues
Ing.Razije NAIPI
Ing.Ana NAIPI